



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:148934

Datë: 10.09.2024

Numri i dokumentit: 06145351

KA.nr. 639/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Agro Petroll” ShPK me NUI 810694663 dhe seli në fshatin Pestovë, në Vushtrri, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson avokati Isamedin Dedinca me seli në rrugën “UÇK”, hy. 170, kati 1, nr. 1, në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, jashtë seancës më 10 shtator 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

Pezullohet procedura e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit “Agro Petroll” ShPK me NUI 810694663 kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër nr. 07/4 3492 të datës 07.06.2021 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të së paditurës.

ARSYETIM

Paditësi më 08.07.2021 ka ushtruar padi kundër të Paditurës me të cilën i ka kërkuar kësaj gjykate anulimin e vendimit me numër nr. 07/4 3492 të datës 07.06.2021 të lëshuar nga e Paditura.

Megjithatë, Paditësi me anë të parashtrësës të datës 06.09.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë për anulimin e vendimit me numër nr. 07/4 3492 të datës 07.06.2021 të së Paditurit.

Duke marr për bazë që sipas nenit 31 para.1 të LKA-së paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi dhe se në këtë rast gjykata e pezullon, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjkata sheh të arsyeshme të sqaroj se, në konfliktit administrativ, sipas nenit të cituar më lartë, nuk kërkohet pëlqimi i të Paditurit për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht nuk e mori mendimin e të Paditurit.

Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.639/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.